



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Letërsi e Gjuhës Franceze

Ngarkesa: 4kredite; 40 orë mësimore; Letërsi e Gjuhës Frënge (20 lek/20 sem.);

Viti / Semestri : Viti III, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Frënge ‘‘ Gjuhë dhe Komunikim’’

Kodi i lëndës:Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon t’ju paraqesë studentëve parimet e estetikës dhe poetikës së shkollës realiste të shekullit XIX si dhe drejtimet e ndryshme e shkollat letrare që lulëzuan gjatë shekullit XX. Lënda është e organizuar në dy module: në gjysmën e parë të semestrit ajo i njeh studentët me prozën realiste franceze të shekullit XIX, kushtet e lindjes dhe të zhvillimit të romanit realist me variantet e ndryshme të tij; në pjesën e dytëparaqiten shkollat e ndryshme letrare që njohu romani francez duke nisur nga fillimi i shekullit XX, si trashëgimi e realizmit deri te romani postmodern e ai mitologjik duke kaluar sigurisht nga romani i absurdit dhe eksperimentet e Romanit të Ri.

Objektivat specifike lëndore: Ajo synon t’i iniciojë studentët njëkohësisht në analizën e veprave më të shquara letrare që shenjuan këtë shekull, përmes përfaqësuesve më të shquar të prozës së shekullit XIX dhe XX. Kjo lëndë i pajis ata me teknika të analizës së teksteve dhe intertekstualitetit si dhe i njeh me një qasje krahasimore që u lejon të kuptojnë evoluimin e romanit francez dhe të formav endryshme të tij. Studentët aftësohen për të përgatitur dhe paraqitur minipunime mbi veprëne njëautori të përzgjedhur nga ata vetë.